

ANEKSI 53

MASAT PER T'U SIGURUAR QE KONTEINERET E MIRATUAR PER TRANSPORT NDERKOAMBETAR ME VULE DOGANORE PERPUTHEN ME SPECIFIKAT PERKATESE; HEQJA E MIRATIMIT

1. Ne qofte se vihet re se kontenieret te cilet jane miratuar nuk perputhen me rregullat teknike te percaktuara ne pikën 391 (5) zyra doganore nuk duhet te njohe vlefshmerine e miratimit, me perjashtim te rasteve kur mangesite e gjetura jane te nje rendesie te vogel dhe nuk krijojne ndonje rrezik per mashtrim.

2. Kur nje kontenier ka nje defekt te madh dhe si rrjedhim nuk perputhet me standartet ne baze te te cilave eshte miratuar per transport nen vulen doganore, autoritetet doganore duhet te informojne personin pergjegjes per kontenieret ne menyre qe ai te mund te riparoje kontenierin sipas kushteve ne te cilat ai eshte miratuar me kusht qe riparimet te perfundohen shpejt. Kur kontenieri eshte riparuar ne menyren e duhur ai duhet te vazhoje per ne destinacionin e tij nen vulen doganore. Ne rastin kur kontenieri nuk eshte riparuar ne menyren e duhur ose kur personi pergjegjes per te preferon t'a riparoje ate ne vendin ku eshte miratuar, autoritetet doganore duhet:

a) te mos pranoje te vulose kontenierin dhe te mos pranoje autorizimin per perdorimin e tij ne transport ne rastet kur vulosja quhet e nevojshme;

ose

b) te levize kontenierin nga perdorimi kur permbajtja e tij transferohet ne nje mjet tjeter transporti;

ose

c) te autorizojte qe te vazhdoje udhetime i tij ne baze te regjimeve te duhura kur nuk ka rrezik per kontrabande, humbje ose demtim te mallrave te transportuara ne kontenier, duke treguar ne dokumentet e tranzitit defektin ne fjale.

Per t'u siguruar qe kontenieri eshte i riparuar sic duhet, autoritetet doganore duhet te revokojne miratimin, nese nje gje e tille konsiderohet e nevojshme.

Kur autoritetet doganore kane revokuar autorizimin ose kur zbulohet nje defekt ne nje grup konteineresh, dhe ato nuk perputhen me standartet ne baze te te cilave jane miratuar per transport nen vulen doganore, autoritetet ose administrata doganore ne Republiken e Shqiperise, qe eshte pergjegjese per miratimin njoftohen sipas rastit. Autoritetet pergjegjese per miratimin fillestar ftohen te marrin pjese ne proceduren per leshimin e nje autorizimi te ri.

3. Nje konteiner konsiderohet se ka defekt te rende ne qofte se:

a) mallrat mund te zhvendosen, ose te futen ne pjesen e vulosur te konteinerit pa lene gjurme te dukshme thyerje ose pa thyer vulen doganore;

b) vula doganore nuk mund te vendoset lehtesisht dhe efektivisht ne te;

c) permban hapësira te padukshme ku mund te fshihen mallrat;

d) te gjitha hapësirat per mbajtjen e mallrave nuk jane te disponueshme menjehere per inspektim doganor.